



Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti III, nr. 10, prill-qershor 2023



Të menduarit bardhë e zi

Faqe 20 – 21

(Foto: pixabay)



Misioni Katolik Shqiptar
Katholische Albanische Mission

LUZERN

faqe

REVISTË INFORMATIVE, KULTURORE
DHE SHPIRTËRORE E MISIONIT KATOLIK
SHQIPTAR NË LUZERN



SELIA E REVISTËS

Rodteggstrasse 6, CH-6005 Luzern
St. Michael



Tel: +41 41 250 52 60



anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch
albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch
ukas_cr@hotmail.com



<https://www.misioni-lu.ch/>



[https://www.facebook.com/ Misioni Katolik
Shqiptar - Luzern](https://www.facebook.com/Misioni%20Katolik%20Shqiptar-%20Luzern)



TË NDIHMOJMË REVISTËN

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3
Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 |
6005 Luzern

REDAKSIA

Dr. Don Anton Uka – kryeredaktor
Motër Vida Ademi – koordinuese
Veneranda Qerimi – redaktore e teksteve
Mirlinda Dushi Berisha – përgjegjëse për
intervista
Gjane Simoni – asistente
Motër Mrika Sabedini – asistente

- 3 EDITORIALI**
Nuk kam kohë!
- 6 AKTIVITETET E MISIONIT**
Meshë e përbashkët në Dagmersellen
- 9 AKTIVITETET E MISIONIT**
Dita e Nënave
- 10–11 AKTIVITETET E MISIONIT**
Lurdi dhe përvoja e qetësisë
- 14 AKTIVITETET E MISIONIT**
Darka e bamirësisë për Katedralen
në Prishtinë
- 16–17 INTERVISTA**
Intervistë me zotëri Mark Dodaj
- 19 PËRSHPIRTËRI**
Festa e Korpit dhe Gjakut të Krishtit
- 22–23 KULTURË**
Grupi i vallëzimit “Shqiponja”
- 24–25 KULTURË**
Dëshmia e Profesorit
- 28–29 KULTURË**
Arbëreshët – shembull i ruajtjes
së identitetit

Nuk kam kohë!

Në librin e fundit *Etika e syçeltësisë*, që shtëpia botuese Drita ka nxjerrë para pak javësh, duke u mbështetur në Letrat baritore të Carlo Maria Martinit, trajtohet tema e të qëndruarit zgjuar në fe, shpresë dhe dashuri.

Që në kapitullin e parë të këtij libri theksohet fakti se Hyji e ka për zemrën kohën e njeriut, prandaj edhe rri zgjuar në pritje të kthimit të të birit që është larguar, që të mos ndihet përfundimisht i braktisur dhe i humbur (krh. Lk 15, 20). Nga kjo kuptohet se “koha nuk është një hapësirë e zbrazët, vend asnjanes, por pjesëmarrje në jetën hyjnore, prejardhje nga Hyji, ardhje e Hyjit dhe ardhshmëri e hapur Hyjit në çdo çast; ajo reflekton prejardhjen, ardhjen dhe ardhshmërinë e Dashurisë së amshuar”, thotë Martini.

Fakti se Hyji, në personin e Jezusit, hyn në vuajtjen njerëzore, përveçse na bën të shohim se si Hyji e bën të vetën kohën e njerëzve, tregon po ashtu se Hyji e njuh ankthin tonë, sidomos për arsye të qëndrimit tonë përballë vdekjes (krh. Mt 26, 37). Kështu që koha është pjesëmarrje e Hyjit në jetën e njeriut, dhe, njëkohësisht, e njeriut në jetën e Hyjit. Nga kjo kuptohet se koha vjen prej Hyjit, zhvillohet nën përcjelljen e vazhdueshme të dashurisë së Tij, dhe është e destinuar për lavdinë e Tij. Kështu që krishterimi nuk është besimi i shpëtimit prej kohës dhe prej historisë, por e kohës dhe e historisë, do të thoshte Martini.

Në fjalët e Jezusit: “*Lazër, dil jashtë!*” (Gjn 11, 43), Martini sheh dëshirën e Zotit për ta liruar njeriun, “jo vetëm prej robërisë së vdekjes, por edhe prej robërisë së kohës së jetuar në iluzion dhe në frustracion”. Kjo do të thotë se Hyji vjen, rri zgjuar mbi jetën e njeriut, është gjithmonë i pranishëm, qan mbi të, e do, njeriut i kërkon thjeshtë që të lejojë të ringjallet prej Tij, i kërkon të jetojë përvojën e lirit dhe të pakuptimit.

Si rezultat i vetëdijes, se Hyji ka gjithmonë kohë për njeriun, lind thirrja që edhe ne të kemi kohë për Hyjin dhe për njëri-tjetrin.

Një prej problemeve qendrore të njeriut të ditëve tona, është problemi i “*nuk kam kohë!*”

Mentalitetin i përgjithshëm i “*nuk kam kohë!*”, takohet nën formën e tre dimensioneve: *Personal* – nuk kam kohë për vetveten; *bashkësior* – nuk kam kohë për të tjerët; *teologjikokishtar* – nuk kam kohë për Hyjin, pra për lutjen, meditimin dhe për Kishën apo për Meshën e shenjtë.

Nevoja për të gjetur kohën, është një nevojë që bashkon dhe që sipas Martinit kërkon një “vendim të vogël, e megjithatë të vështirë, sepse të gjithë ose pothuajse të gjithë kemi për të kryer shumë gjëra; si rrjedhojë themi se na mungon koha dhe ndihemi të ndjekur prej ikjes së ditëve, të munduar prej afateve që na dalin përpara dhe do të na befasojnë tashmë jashtë kohës së duhur”.

Përvoja dëshpëruese e “*nuk kam kohë!*”, fsheh brenda vetes një thesar të madh: “atë të thirrjes sonë për të zotëruar me paqe një kohë jo më të ngrënë prej ritmit të pamëshirshëm të kronometrit, por të mbushur me një plotësi që nuk zhgënjën; një kohë të vërtetë, pikërisht krejt për ne dhe për të tjerët, që duhet shpenzuar me gëzim, harmoni, entuziazëm, freski dhe paqe”.

Tani që jemi në prag të pushimeve verore, uroj që të gjeni kohë për veten tuaj, për të tjerët dhe për Hyjin, sepse të jetuarit kështu do t’i japë kuptim dhe shenjtërim kohës së ditëve tona.



(Foto: don Anton Uka)

Ditën e enjte me 30 mars u bë hapja e përtëritjes shpirtërore në Misionin Shqiptar në Luzern nga Don Prekë Lazraj i ftuar qëllimisht për këtë seminar nga misionari Don Anton Uka.

Së pari Don Antoni i dha përshëndetjen e mirëseardhjes Don Prekës, përshëndeti të pranishmit gjithashtu duke i falënderuar për praninë e tyre në këtë përtëritje.

Tema kryesore e trajtuar gjatë ditëve të përtëritjes ka qenë "Rrëfimi" sakramenti i pajtimit me Zotin dhe njëri-tjetrin.

Ditën e premte u mbajt përshpirtëria e ud-

hës së Kryqit dhe Mesha shenjtë ku predikimi ishte vazhdim i temës mbi rrëfimin.

Dita e shtunë me datë 1 prill u karakterizua nga dy pjesë. Në pjesën e parë u bë vazhdimësia e trajtimit të temës së kushtuar Sakramentit të rrëfimit. Ndërsa në pjesën e dytë, kjo vazhdimësi u mbajt duke ju dhënë mundësi të pranishmëve që të bëjnë reflektimet dhe pyetjet e tyre në lidhje me temën e zhvilluar. Ishte një pjesëmarrje shumë e sinqertë duke nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të jetës sonë të cilën e jetojmë sot lidhur me marrëdhënien tonë me Zotin dhe me të përditshmen në të cilën e jetojmë.


Don Preka së bashku me Don Antonin gjatë përgjigjeve të tyre theksuan edhe një herë më shumë qëndrimin e Kishës lidhur me realitetet e ndryshme të cilat u paraqitën nga pjesëmarrësit në përtëritjen shpirtërore.

Më 2 prill të Dielën e Larit, Mesha në kishën e Shën Gjergjit në Sursee u udhëhoq nga Don Prekë Lazraj në bashkëkremtim me Don Anton Uka me një pjesëmarrje të madhe të besimtarëve. Mesha u transmetua drejtpërdrejt në Radio Marinë Shqiptare dhe në rrjetet sociale.



(Foto: Nue Tuqi)

Shkruan: Orsolina Paluca, Tiranë



FESTA E PASHKËVE NË MISIONIN TONË

Pas përgatitjes me seminarin shpirtëror tre ditor të udhëhequr nga don Prek Lazraj, drejtor i Radio Marisë së Shqipërisë, i cili trajtoi temën e sakramentit të rrëfimit. Si dhe pas mundësisë së rrëfimit për të gjithë besimtarët, kjo edhe falë meshtarëve që kishin ardhur për këtë qëllim, filluam kremtimin e Javës së Madhe dhe festën e Pashkëve.

Treditëshin i Pashkëve u kremtua në Qendrën tonë në St. Michael, në Luzern. Të Enjten e madhe, Mesha e Darkës së fundit ka filluar në ora 20:00, gjatë kremtimit si përkujtim i asaj çfarë Jezusi ka bërë në Darkën e fundit duke i larë këmbët apostujve, don Antoni iu ka larë këmbët 12-të personave. Larja e këmbëve tregon gjestin



(Foto: Nue Tuqi)

e shërbimit të vërtetë me dashuri dhe këtë Jezusi e ka bërë me vetëdije të plotë. Pas përfundimit të Meshës shenjte ishte përgatitur darka për apostujt tanë dhe për familjet e tyre, si dhe për disa bashkëpunëtor të Misionit tonë. Darkën u përgatit nga Engjëll Marku, së bashku motrat.

Të Premten e madhe, si zakonisht, në shenjtëroren e Zojës në Einsiedln, në orën 13:00, tri Misionet Katolike Shqiptare në Zvicër, luten së bashku përshpirtërinë e Udhës së kryqes në shenjtëroren e Zojës. Pjesëmarrja e besimtarëve ishte vërtetë e madhe. Ndërsa, në mbrëmje në kishën e qendrës tonë në Luzern, u mbajtën ritet e Mundimeve të Krishtit, ku më pas gjatë gjithë kohës, deri në mesnatë, besimtarët kanë ardhur familjarisht për tu lutur dhe adhuruar tek varri i Krishtit.

Të Shtunën e madhe, në vigjiljen e Pashkëve, Mesha shenjte është kremtuar në Inwil dhe në Luzern. Kurse të dielën e Pashkëve Mesha shenjte është kremtuar në Goldau dhe në Emmenbrücke. Në të gjitha kremtimet e Meshës kishat ishin të stërmbrushura me besimtarë. Ministrantët, lexuesit, si dhe kori e kanë bërë edhe më madhështore Meshën e shenjtë.

Shkruan: m. Vida Ademi, Luzern



Foto: don Anton Uka

FESTA FAMILJARE E PASHKËVE

Më 10-të prill Misioni ynë ka organizuar festën familjare të Pashkëve. Kremtimi i festës familjare është bërë në Qendrën italiane Papa Giovanni në Emmenbrücke. Morën pjesë familje të shumta nga Misioni ynë, kurse këngëtari i njohur zotëri Dodë Kalaj, krijoi atmosfere të bukur i cili e bëri publikun të përjetojë qaste gëzimi duke marrë pjesë masivisht në vallëzim.

E veçanta e kësaj feste ishte se grupit i rinjve të ansambllit “Shqiponja”, që është for-

muar kohët e fundit, për herë të parë shfaqen vallet e tyre kombëtare para publikut të Misionit. Paraqitja e tyre ishte shumë e bukur duke ngjallur gëzim dhe kënaqësi por edhe duke zgjuar të gjithë të pranishmit ndjenja të bukura atdhedashurie. Të rinjtë ishin të veshur me veshje kombëtare dhe kanë dhënë një program vallesh shumë të bukura duke dëshmuar kështu talentin dhe profesionalizmin e tyre.

Shkruan: Redaksia

Meshë e përbashkët në Dagmersellen

Më 23 prill, të dielën e tretë të Pashkëve, në kishën famullitare në Dagmersellen është kremtuar Mesha e përbashkët me besimtarët shqiptarë dhe zviceran të kësaj famullie. Meshën e ka udhëhequr, në gjuhën shqipe dhe gjermane, don Anton Uka, misionar përgjegjës i Zvicrës qendrore. Në fillim të Meshës, Katharina Jost, në cilësinë e nikoqires, bëri përshëndetjen duke shprehur falënderimin e saj për këtë përvojë të bukur të përbashkët duke uruar që kjo të përvojë të

vazhdojë edhe në të ardhmën. Po ashtu edhe don Antoni falënderoi përfaqësuesit e kësaj famullie dhe të gjithë të pranishmit, duke theksuar se përvojat e tilla duhen promovuar edhe më tepër, për faktin se të gjithë i takojmë një Hyji të vetëm, edhe pse vijmë dhe jemi pjesë e kulturave dhe gjuhëve të ndryshme.

Kori i Misionit tonë, në krye me m. Mrika Sabedini, bëri një këndim liturgjik shumë të mirë dhe paraqitje dinjitoze, për çka edhe u vlerësua lart nga të pranishmit. Ata kremtimin e Meshës shenjte e bënë edhe më të bukur me zërat e tyre. Por mund të thuhet se Kori është gjithmonë i pranishëm gjatë të dielave dhe festave në Meshën shenjte dhe me zërin e tyre lëvdojnë Zotin, sepse sikurse ka thënë shën Augustini: “kush këndon lutet dy herë” dhe liturgjinë e bëjnë më të këndshme dhe më të gëzueshme për të gjithë besimtarët e pranishëm.



(Foto: Gaspër Merturi)

Shkruan: Redaksia



RIPËRTËRITJE SHPIRTËRORE E MOTRAVE

Njeriu shpesh ka nevojë që të ndalojë, së paku një herë në muaj, të lërë të gjitha angazhimet e tija të përditshme dhe të thellohet në jetën e tij të brendshme, shpirtërore por edhe për një pushim fizik. Kështu bëmë edhe ne motrat e të tri misioneve që veprojmë e jetojmë në Zvicër, së bashku me motrat e misionit kroat. Me ftesën e motrave kroate dhe me dëshirën e madhe të motrave që veprojnë në Luzern, Aarau dhe Thurgau, u mbledhëm së bashku më 1 maj, në Qendrën e Misionit Katolik kroat në Luzern. Takimin tonë e përshëndeti dhe e mirëpriti misionari kroat pater Branko, bashkë me provincialen e motrave. Takimi ynë i përbashkët filloi me një meditim të udhëhequr nga M. Mirjam. Tema e takimit ishte «Përvujtëria në jetën e Marisë». Të thelluarit mbi përvujtërinë, si një aspekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për jetën tonë si motra por mbi të gjitha për jetën tonë si të krishterë, na bëri të hyjmë në brendësinë tonë dhe të pyesim veten; sa i përngjaj unë Zojës së Bekuar në aspektin e përvujtërisë? I krishteri duhet të jetë patjetër në “shkollën e Marisë”, aty ku mësohet përvujtëria e vërtetë, sepse përvujtëria është sekreti që na qon tek Zoti. Zoti i pëlqen shumë përvujtëria. Ajo çka i

ka dalluar shenjtërit nga të tjerët ka qenë përvujtëria që ata kanë patur. Duke u përvujtëruar janë lidhur më shumë në Zotin, si të vetmin dhe shpresën e jetës së tyre. Pas ligjëratës shkëmbyem mendime dhe eksperiencë secila në punën dhe angazhimet e veta. Ishte një pasuri e madhe të dëgjonim secilën nga ne për mënyrën e organizimit të jetës së misionit. Më pas, At’ Branko, misionar kroat, kremtoi Meshën shenjte për të gjitha ne dhe më pas vazhduam me drekën e përbashkët, të ofruar prej tyre.

Pasditja vazhdoi me lutjen e përbashkët të rruzares së shenjtë, dhe vizituam ambientet e misionit kroat. Ishte kënaqësi të qëndruarit së bashku. Planifikuam që këto lloj takimesh ti përsërisim shpesh në mënyrë që lidhjet tona ti forcojmë edhe në vazhdim. U ndamë duke marrë nga ky takim shumë kujtime të bukura. Takimi ishte sa i nevojshëm aq edhe i frytshëm. Mikpritja dhe organizimi i motrës Ana Marija, na kanë lënë mbresa të mëdha. Ndonjëherë mjafton të ndalemi përpara Zotit, dhe menjëherë diçka ndryshon në zemrën tonë. Falënderojmë Zotin për këtë ditë të bukur.

Shkruan: m. Luiza Milani, Sirnach



Të shtunën, më 13 maj, është kremtuar festa e Zojës së Fatimes. Misionet e gjuhëve të ndryshme që jetojnë dhe punojnë në kantonin e Luzernit janë bashkuar të gjithë së bashku në famullinë e Sursees, dhe së bashku kemi kremtuar festën e Zojës. Në fillim ishte procesioni nëpër qytetin e Sursees, me grupe të ndryshme muzikore, me veshje kombëtare dhe me lutje u përshkua një pjesë e qytetit të Sursees dhe jemi kthyer në kishën e famullisë St. Gerorg në Sursee. Pasi hyrjes në kishën e famullisë, ka filluar kremtimi i Meshës

shenjte me shumë meshtarë dhe përgjegjës të famullisë.

Kremtimi i Meshës shenjte ishte në gjuhë të ndryshme të Misioneve përkatëse të pranishme, por kryesonte gjuha portugeze, duke pasur para sysh se Zoja e Fatimes është shfaqur në Portugali. Kori me këndimin e tyre e bëri këtë kremtim edhe më të bukur. Zoja e Fatimes le të ndërmjetësojë te Biri i saj hyjnor për gjithë ata që mbështetën në të.

Shkruan: Redaksia

65 vjetori i motrës Vida

Të urosh dikë për ditëlindje të lumtur është një mënyrë për të njohur dhe festuar ditën e tyre të veçantë. Ditëlindjet janë raste ku njerëzit shpesh ndihen të dashur dhe të vlerësuar, kështu që duke i uruar dikujt ditëlindje të lumtur mund të ndihmojë gjithashtu për ta forcuar marrëdhënien me atë person. Ditëlindjet janë një kohë për të reflektuar mbi vitet e kaluara dhe për të shikuar të ardhmen me shpresë. Por ditëlindjet nuk kanë të bëjnë vetëm me personin që feston, ato ndërlidhen edhe me



(Foto: Nikollë Ukaj)

jetën e familjarëve dhe të miqve të cilët, zakonisht, shprehin ndjenja gëzimi dhe falënderimi ndaj personit që feston. Edhe ditëlindjet janë një mundësi për të përforcuar marrëdhëniet tona të mira dhe të shëndetshme.

Motër Vida, e cila shërben në Misionin tonë, ka festuar 65 vjetorin e lindjes së saj. Anëtarët e korit dhe forumi i grave të Misionit tonë si gjithmonë janë të gatshëm të bëjnë surpriza. Prandaj edhe këtë herë organizuan një darkë solemne me ushqimet tradicionale shqiptare të sjella nga shtëpitë e tyre.

Të pranishmit në festë po ashtu kishin përgatitur një dhuratë të çmueshme dhe simbolike për m. Vida.

Motrës Vida i urojmë shëndet dhe jetë të gjatë, ndërsa të gjithë atyre që morën pjesë në festën e ditëlindjes së saj i falënderojmë duke uruar të mira dhe bekime në jetën e tyre personale dhe familjare.

Shkruan: m. Mrika Sabedini



DITA E NËNAVE

Foto: Kastriot Domgjonij

Si çdo vit kremtuam ditën e nënës të dielën e dytë të muajit Maj, më 14.05. Prandaj le të paraqesim një historik të shkurtër lidhur me ditën e nënës.

Dita e Nënës është një festë ndërkombëtare për të nderuar Nënën, rëndësinë, rolin dhe ndikimin e tyre në familje dhe shoqëri. Dita e Nënës i ka rrënjët në lëvizjen e grave angleze dhe amerikane të shekullit të XIX - të, kur amerikania Ann Maria Reeves Jarvis në vitin 1865 organizoi Takimet e Ditës së Nënave. Në këto takime nënat mund të shkëmbejnë mendimet dhe dëshirat e tyre për një pozitë më të mirë të gruas në shoqëri, të drejtat e tyre e sidomos për arsimimin e vajzave të reja. Pas shumë përpjekjeve, presidenti amerikan Thomas Woodrow Wilson shpalli një ditë ndërkombëtare të gruas në vitin 1914. Por përpara amerikanëve, që nga shekulli XVII deri në shek. XIX, britanikët e varfër të dielën e katërt të kreshmëve morën një ditë pushim nga punëdhënësit e tyre për të vizituar nënat e tyre dhe për të kaluar këtë kohë me to, e quajtur "E Diela e Nënës".

Në Zvicër si dhe në shumë vende të botës, Dita e Nënës festohet në të dielën e dytë të muajit Maj. Festa e Ditës së Nënës filloi me fjalën përshëndetëse të don Antonit. Pasi që kryetarja e Forumit të Grave zonja Vjollca Bisaku nuk ishte e pranishme, pata rastin t'ju uroj nënave mirëseardhje dhe argëtim të kënds-

hëm. Pastaj don Antoni beri bekimin e bukës dhe lutjen në nder të Ditës së Nënës.

Kjo ditë sikurse çdo vit organizohet nga Forumi i grave të MKSH- Luzern me qëllim humanitar në bashkëpunim me misionarin tonë don Antonin dhe m. Vida e m. Mrikë. Të hollat që mbledhen këtë ditë u dërgohen nënave, grave të veja si dhe njerëzve në nevojë të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira në Kosovë. Ndoshta kjo ndihmë është vetëm një pikë uji në varfërinë e tyre të skajshme, por këta njerëz janë aq bujar e falënderues sa që e urojnë, e bekojnë dhe luten për Misionin, gratë e Misionit tonë e për të gjithë ata që u ndihmojnë. Si çdo herë përveç darkës nuk mungoi as kënga e vallja e shoqëruar nga këngëtari i mirënjohur Kolë Oroshi, i cili me këngët e tij e rriti dhe e zbukuroi këtë ditë të veçantë për nënat. Në festën e Nënës, e cila zgjati deri në orët e mbrëmjes, morën pjesë rreth 200.

Të gjitha Nënave (grave) ju dëshirojmë të jenë një shtyllë e fortë e një shembull i mirë për Familjen dhe shoqërinë në të cilën jetojnë, vepronë e punojnë. E në emër të Forumit të Grave si dhe në emrin tim personal i falënderoj të gjitha nënat e gratë, që gjithmonë janë të gatshme të japin ndihmesën e tyre sado që të jetë i vogël, por me zemër të madhe.

Shkruan: Aida Avgustini, Ebikon



LURDI DHE PËRVOJA E QETËSISË

(Foto: Anonim)

Secili prej 12 muajve të vitit ka një temë apo një devocion të caktuar që Kisha Katolike e praktikon duke ftuar besimtarët që të lutën për atë qëllim. Edhe kjo është një mënyrë e mirë për të jetuar jetën tonë shpirtërore. Kur përmendim muajin maj, për ne që jemi besimtarë të besimit katolik, natyrshëm na shkon mendja dhe zemra te figura e Zojës së Bekuar.

Udhëtimet tona gjatë jetës na japin shumë përvoja të veçanta të cilat behën themele të besimit dhe dëshmisë tonë. Lurdi, si qytet i vogël në jugperëndim të Francës, vazhdon të jetë një ndër shenjtëroret më të njohura në botë që i kushtohet Zojës së bekuar.

Tashmë kanë kaluar 18-të vite që kur isha në shtegtim te Zoja në Lurd, dhe mendoj: “Asgjë nuk mund të jetë e bukur pa të vërtetën” sepse aty mund të gjesht qetësinë shpirtërore dhe fizike.

Në mbrëmjen e 17-të majit, 280 shtegtarë, pasi morëm bekimin nga misionari ynë, u akomodam në autobus dhe u nisem drejt shenjtërores së Lurdit. Ishte kënaqësi kur shikoje një numër kaq të madh besimtarësh, me njete dhe qëllime

të mira dhe shumë të gëzuar që po udhëtonin për në shenjtëroren e Lurdit. Disa prej tyre shtegtonin për herë të parë, dhe ajo që më bëri përshypje ishte pjesëmarrja e madhe e të rinjve, diku rreth 80-të të rinj dhe të reja e bënë edhe më të veçantë përvojën tonë.

Përgjatë udhëtimit u krijua një klimë familjare, u lutem së bashku që me ndërmjetësinë e Zojës të shkoj gjithçka mirë. Pas 14 orëve udhëtim, më të mbërritur në Lurd, në fytyrën e secilit vërehej një ndjenjë e veçantë falënderimi se gjithçka shkoi mirë.

Pas akomodimit në Hotel, drekës së përbashkët në hotel kishim kohë të lirë. Për të gjithë të pranishmit ishte përgatitur një planprogram në të cilin ishin të shënuara takimet dhe kremtimet tona të përbashkëta. Edhe pse moti nuk ishte ashtu sikurse e dëshironim ne, megjithatë asgjë nuk na pengoi që të përjetonim në mënyrë të thellë dhe të bukur këtë përvojë.

Në Lurd ishte mundësia të takoheshim edhe me besimtarë nga Misionet tjera në Zvicër duke kremtuar Meshët, Udhën e Kryqes dhe lutjen e



(Foto: Anonim)



(Foto: don Anton Uka)

Ruzares e cila ishte e përgatitur shumë mirë, veçanërisht procesioni solemn, ku këndohej dhe lutej në gjuhë të ndryshme, edhe në gjuhën shqipe. Kjo përvojë e mrekullueshme bënte të mendonim se edhe pse të ndryshëm në kulturë dhe gjuhë, të gjithë jemi bijtë e Zotit dhe secili është në udhëtim drejt Tij.

Ditën e fundit të qëndrimit tonë në Lurd, përveç fotografisë së përbashkët, u bë edhe riti i veçantë i nderjes dhe kushtimit të qiriut të madh, që në shenjë e falënderimi i kushtohet Zojës së Bekuar dhe përmes këtij gjesti sikur i thuhet Nënës tonë qiellore: “Ne po kthehemi në familjet tona, por zemra, mendja dhe njetet tona të mira qëndrojnë dhe mbesin gjithmonë me Ty”.

Klima miqësore dhe familjare, që tashmë ishte krijuar, e karakterizuar me lutje, këngë, humor dhe shaka na përcolli edhe në udhëtimin e kthimit. Përvojat e tilla mbesin gjatë në zemrën dhe mendjen tonë, prandaj edhe dëshira për tu rikthyer në këto vende të shenjta është e madhe.

Shkruan: Valentina Prenrecaj, Root



MIQ NË MISIONIN TONË

Në mbrëmjen e 24 majit, në qendrën e Misionit tonë në Luzern, Këshilli Administrativ i Kishës vendore – Landeskirche në Luzern, vikari ipeshkvor Hanspeter Wasmer, përfaqësues të Misionit italian, portugez, anglez, polak, kroat dhe spanjoll vizituar Qendrën tonë.

Në orën 18:45 u mbajt mbledhja e përbashkët, ku u shqyrtuan pyetje të ndryshme në lidhje me Misionet e gjuhëve të huaja që veprojnë në kantonin e Luzernit. Pas përfundimit të takimit të përbashkët në ora 20:00 ishte darka e përbashkët për të gjithë të pranishmit që ishte e përgatitur prej Misionit tonë dhe e ofruar nga Landeskirche. Darkën e shijshme dhe të kombinuar mes ushqimeve tona shqiptare dhe atyre zvicerane, u përgatit nga Kastriot Frokaj me familje, të cilët i falënderojmë shumë.

Don Antoni, në cilësinë e nikoqirit, përshëndeti të pranishmit duke ju dëshiruar mirëseard-

hje. Ai, para se të bënte lutjen dhe bekimin e darkës, bëri një paraqitje të Misionit tonë duke theksuar se: “Misioni ynë shtrihet në tetë kantone me rreth 15.000 besimtarë shqiptarë, kryesisht të ardhur nga Kosova. Në këto tetë kantone zhvillojmë veprimtari baritore dhe kulturore: Meshë të shenjta, pagëzime, vajime, katekizëm, vizita familjare, bekimet të shtëpive dhe shumë aktivitete të tjera kulturore dhe shpirtërore. Jemi të lumtur dhe shumë të nderuar t’ju kemi në mesin tonë. Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe për dëshminë e fesë. Falënderimi ynë i veçantë shkon për përgjegjësit e Kishës Vendore këtu në Luzern për mbështetjen dhe kujdesin që vazhdimisht tregojnë për ne”.

Në fund, për të gjithë të pranishmit, qe përgatitur një dhuratë modeste, një kavanoz me reçel.

Shkruan: Redaksia



Shtegtimi i organizuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Luzern, u mundësua edhe këtë vit nga Misionari ynë Don Anton Uka, në bashkërendim me Pjetër Gjonin dhe Gjergj Përnrecajn, të cilët i falënderojmë shumë për angazhimin. Këtë vit pjesëmarrja ishte e jashtëzakonshme, mbi 50-të pjesëmarrës!

Nisja ishte nga Verkehrshaus Luzern, në ora 6:00, gjatë shtegtimit u bënë tre pauza, dhe aritja në Einsiedel ishte rreth orës 18:00! Pastaj ishte Mesha shenjte e udhëhequr nga don Antoni, si dhe në fund u mbajt darka e organizuar dhe e

ofruar nga Misioni ynë, përgjegjësit e të cilit i falënderojmë përzemërsisht për këtë angazhim.

Shtegtimi ishte një përjetim i bukur, edhe pse rrugë e largët dhe me besimtarë të moshave të shtyra, përkundër vapës që mbretëronte, forca e besimit dhe njëjtëve të bëra ishte më e madhe se çdo pengesë!

Lutem që Zoja e bekuar t'i plotësojë të gjitha njetet tona, me shpresë që kjo traditë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shkruan: Dukagjin Qollaku, Hochdorf

Festa e Rrëshajëve

Përveç kremtimit të Meshëve dhe përgatitjes shpirtërore, në Misionin tonë tashmë është bërë traditë që e hëna e Rrëshajëve të festohet



(Foto: don Anton Uka)

bashkarisht me anëtarët e grupeve të ndryshme. Kështu që me këtë rast Misioni ynë organizoi Grillfest në të cilën morën pjesë më shumë se 60-të persona.

Ishte një festë shumë e bukur, e organizuar mirë, dinamike dhe e pasur me ushqime të shijshme. Edhe kjo mbetet një përvojë feje dhe miqësie, që të udhëhequr nga Shpirti Shenjt të rritemi në shoqëri dhe miqësi me njëri-tjetrin.

Njëra ndër dhuratat e Shpirtit Shenjt është edhe harmonia, prandaj edhe urojmë që gjithmonë në miqësi dhe harmoni t'i kalojmë festat tona.

Shkruan: Redaksia



Në ditën e fundit të muajit Maj, në festën e Vizitës së Virgjërës Mari, Misioni ynë e mbylli këtë muaj kushtuar Virgjërës Mari me lutjen e rruzares dhe Meshën e shenjtë në shenjtëroren e vogël në Luthern Bad.

Në Meshë ishin të pranishëm një numër i mirë besimtarësh, të cilët kishin ardhur nga vende të ndryshme të Misionit tonë për të lutur

dhe falënderuar Zojën e Bekuar për huret e shumta që ajo vazhdimisht zbraz mbi jetën dhe familjet tona.

Përvojat e tilla, si gjithmonë, janë mundësi të mira për ta thelluar marrëdhënien tonë me Hyjin dhe njëri-tjetrin.

Shkruan: Redaksia

Darka e bamirësisë për Katedralen në Prishtinë

Të shtunën, me 3 qershor, Misionet Katolike Shqiptare në Zvicër kanë organizuar Darkë Bamirësie për ndërtimin e këmbanares së dytë të Katedrales Nënë Tereza në Prishtinë.

Në këtë darkë ishin të pranishëm rreth 150



(Foto: Anonim)

persona, të cilët kishin ardhur për të mbështetur këtë iniciativë.

Hapjen e mbrëmjes e bëri misionari ynë, don Anton Uka, i cili në emër të tri Misioneve në Zvicër përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit.

Në këtë darkë ishte i pranishëm edhe ipeshkvi i Kosovës, mons. Dodë Gjergji, i cili falënderoi dhe nxiti të pranishmit që të ndihmojnë në realizimin e këtij projekti.

Mbrëmja kishte po ashtu edhe sfond kulturor dhe artistik, të përgatitur nga Misioni në Aarau, që përmes fjalimeve dhe këngëve të bukura shqiptare dhe shërbimit me ushqime të shijshme, kaluam vërtete qaste të bukura. Shpresojmë se edhe të ardhurat do të grumbullohen, e kështu të përfundojë puna në katedralen e Shën Nënë Terezës në Prishtinë.

Shkruan: Redaksia



(Foto: don Anton Uka)

Më 2 qershor, Kisha Katolike në Luzern, në vende të ndryshme, ka organizuar takime të shumta kulturore dhe shpirtërore.

Misionet e gjuhëve të huaja të Luzernit, janë bashkuar në Kishën Santa Maria në Emmen. Fillimisht është bërë prezantimi i Misioneve dhe i kulturave tona të prejardhjes, pastaj edhe janë kënduar këngë të ndryshme fetare.

Misionin tonë dhe figurën e Nënë Terezës e ka prezantuar Simon Rosaj, ndërsa Kori ynë ka kënduar këngën kushtuar Shën Nënë Terezës.

Pas përvojës kulturore dhe shpirtërore, në

qendrën italiane, për të gjithë të pranishmit, ishte përgatitur një darkë modeste me ushqime dhe pije tradicionale të popujve të pranishëm në festë. Edhe besimtarët e Misionit tonë sollen ushqime dhe pije tipike shqiptare të cilat u pëlqyen nga të pranishmit.

Falënderimi për këtë organizim i takon të gjithëve që kanë marrë pjesë, sidomos Ardian Markut, Simon Rosajt dhe anëtarëve të korit që kanë kontribuar drejtpërdrejt në organizimin dhe paraqitjen e pjesës tonë.

Shkruan: Redaksia

Festa e Shën Ndout

Devocioni dhe përshpirtëria e popullit tonë ndaj shenjtit të Padovës është e veçantë dhe origjinale, si në pak popuj të tjerë.

Gjatë 13-të të Martave, kushtuar Shën Nd-



(Foto: Kastriot Frokaj)

out, Mesha e shenjtë ishte e mbushur me besimtarë të cilët me lutje dhe përshpirtëri dëshmuan dashurinë për Krishtin dhe shenjtërit e Tij.

Edhe në ditën e Shën Ndout, edhe pse ditë pune dhe me angazhime të shumta, besimtarët gjetën kohë për të ardhur në Meshë dhe për të kremtuar së bashku festën e Shenjtit të mrekullive të shumta.

Pas Meshe, për të gjithë të pranishmit, familjet e Misionit tonë sollen ushqime të shijshme dhe të shumta dhe kështu, bashkarisht, festuam festën e Shën Ndout.

Shkruan: Redaksia

INTERVISTË ME ZOTËRI MARK DODAJ

KËSHILLTARË I MISIONIT KATOLIK SHQIPTAR NË LUZERN



Zotëri Mark Dodaj, ju falënderoj nga zemra për kohën tuaj që ndatë bashkë me ne!

Ju falënderoj për mundësinë e kësaj interviste. Ndjehem vërtetë i lumtur që kam mundësinë të bashkëndajë përvojat, mendimet, vizionet dhe këshillat e mia me lexuesit e revistës Misioni ynë.

Kush është Mark Dodaj dhe prejardhja e tij?

Jam i njohur për angazhimet e mia në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern dhe për kontributin tim në komunitetin lokal. Jam i lindur më 10 prill 1960 në fshatin Krushevë e Madhe, komuna e Klinës, famullia e Budisalcit, nga baba Kolë dhe nëna Marte (Mire) Dodaj. Në vitin 1986 kam emigruar në Zvicër për të gjetur mundësi të reja dhe për të ndërtuar një jetë më të mirë për vetën dhe familjen time.

Gjatë viteve 90-të fillova të angazhohem si këshilltar në Misionin Katolik.

Ky angazhim më mundësoi t'ju ofroj ndihmë dhe këshillim individëve dhe familjeve. Shërbimi ynë si këshilltarë, përveç angazhimeve të ndryshme në aktivitete të Misionit, po ashtu mundohemi të jemi pranë besimtarëve duke u bërë zëri i Misionit, sidomos në zonat ku jetojmë.

Si ishte fillimi juaj në shtetin Zvicran?

Fillimi im në Zvicër ishte sfidues, por mënyra se si u bëra pjesë e këtij shteti më dha shumë mundësi dhe përparësi të reja në jetën time. Pas arritjes time në Zvicër, vendosa të vazhdoj punën time si ndërtimtar, një profe-

sion që kisha ushtruar gjithmonë dhe që më ofronte siguri dhe stabilitet.

Në fillim ishte sfiduese të jetoja në një vend të ri pa familjen time. Kam jetuar vetëm për tre vite, por kjo periudhë më bëri të mësoj shumë në lidhje me vetën time dhe të jem më i pavarur në vendin e ri. Me kalimin e kohës, arrita të vendosja një jetë të qëndrueshme dhe gradualisht i solla familjen time në Zvicër.

Tani jam babai i tre vajzave dhe një djali. Djali im u lind në Zvicër, duke i dhënë jetës sime një ndjenjë të fortë lidhjeje me këtë vend. Pavarësisht largësisë fizike, kam pasur një kontribut të vazhdueshëm për familjen time në Kosovë, duke ofruar mbështetje financiare dhe emocionale nëpërmjet ndihmës ekonomike së fituar në Zvicër. Punësimi si ndërtimtar ka qenë pjesë integrale e identitetit tim dhe kam pasur rendësi të veçantë të krijoj lidhje me komunitetin e ndërtimtarëve në Zvicër. Kam ndërtuar lidhje të fortë dhe kam bashkëpunuar me kolegët e mi për të ofruar shërbime cilësore dhe kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës në këtë vend.

Gjatë gjithë kohës, kam mbajtur afërsinë me Kosovën dhe kam pasur një kontribut të vazhdueshëm për familjen time atje. Për mua është e rëndësishme të ruaj lidhjet me origjinën time dhe të jap ndihmën time kur është e nevojshme.

Kontributi im për familjen në Kosovë ka qenë një përgjegjësi e rëndësishme dhe diçka që më ka mbajtur të lidhur me rrënjët dhe vlerat e mia.

Zotëri Dodaj si fillojë lidhja juaj me Misionin Katolik Shqiptar në Luzern?

Lidhja ime me Misionin Katolik Shqiptar në Luzern nisi nga një përpjekje familjare për të ndihmuar në ndërtimin e kishave në Kosovë.

Unë dhe familjarët e mi, me firmën tonë «Vëllezërit Dodaj», kemi pasur përvojë në fushën e ndërtimit dhe kemi punuar në projekte të ndryshme, përfshirë ndërtimin e objekteve fetare.

Kjo përvojë dhe ky pasion për të kontribuar në komunitetin tonë më bëri të ndihesha tërësisht i përkushtuar ndaj Misionit. Nëpërmjet kontakteve dhe bashkëpunimit me meshtarët nga Kosova, gjatë gjithë jetës sime, në organizime të ndryshme, u njohëm me Misionin Shqiptar në Luzern, Mision ky që gjithmonë ka ditur t'i qëndrojë popullit pranë, si këtu në Zvicër po ashtu edhe në atdhe.

Cilat janë detyrat e një këshilltari në Mision dhe si qëndron bashkëpunimi mes jush?

Këshilltari është i zgjedhur nga meshtari, përgjegjës i Misionit, dhe si i tillë është bashkëpunëtor i ngushtë i tij. Pastaj në koordinim me meshtarin dhe këshilltarët e tjerë janë në shërbim të komunitetit që e përbën Misionin. Në mbledhjet tona të rregullta diskutojmë për çështje të ndryshme që ndërlidhen kryesisht me jetën e Misionit, aktivitetet e tija si dhe për jetën e besimtarëve dhe të familjeve.

Përveç kësaj, në Meshët e të dielave dhe festave, sipas një programi të caktuar, jemi në shërbim të meshtarit dhe besimtarëve të pranishëm, po ashtu organizojmë dhe ndihmojmë meshtarin në vizitën dhe bekimin e familjeve.

Sa ka dallim angazhimi i të rinjve në të kaluarën me të tashmen?

Teknologjia dhe problemet sociale me të cilat ballafaqohemi sot e kanë ndryshuar dukshëm angazhimin e të rinjve, kjo domethënë se tani ndodhemi përballë sfidave të reja me të cilat duhet të ballafaqohemi. Megjithatë të rinjtë janë pjesë e rëndësishme e Misionit tonë dhe gjithmonë janë angazhuar në aktivitete të ndryshme shpirtërore, kul-

turore dhe humanitare. Tani më gëzon fakti se dhe në revistën “Misioni ynë” po angazhohen të rinjtë, sikurse jeni edhe ju, por edhe në Ansamblin e valleve “Shqiponja” është bashkuar një numër i madh i të rinjve dhe të rejave të cilët me zell, përkushtim dhe dashuri po punojnë në promovimin e gjuhës, kulturës dhe të vlerave tona kombëtare. Kjo është e jashtëzakonshme, pasi që kjo rini është aktive edhe në aktivitete të tjera të organizuara nga Misioni.

Zotëri Dodaj, cili është mesazhi, për të gjithë lexuesit e revistës «Misioni ynë»?

Lexuesit e dashur të revistës «Misioni ynë», i ftoj dhe njëkohësisht i inkurajoj të lexojnë temat e ndryshme shpirtërore dhe kulturore, si dhe përmes artikujve dhe ngjarjeve të shumta të pasqyruara në këtë revistë të jenë të bashkuar me Misionin, pasi që kjo është arsyeja e këtij angazhimi dhe investimi që kjo revistë të arrijë në çdo familje të Misionit tonë.

Po ashtu i ftoj që të përçojmë tek të gjithë mesazhin e paqes, mirësisë dhe tolerancës, duke kultivuar dhe promovuar vlerat e trashëgimisë tonë të përbashkët. Të bashkuar mund të bëjmë gjëra të mëdha dhe të bukura.

Zotëri Dodaj, ju falënderoj nga zemra për bashkëpunimin tuaj në dhënien e kësaj interviste?

Ju falënderoj përzemërsisht për ftesën për të bashkëpunuar në dhënien e kësaj interviste. Ishte një përvojë e mrekullueshme dhe kënaqësi e veçantë për të bashkëndarë me ju dhe lexuesit përvojën time të këshilltarit në Mision.

Ju uroj suksese të shumta dhe shpresoj të vazhdojmë të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen për të mirën e Misionit dhe popullit tonë në përgjithësi.

Intervistoi: Mirlinda Dushi Berisha, Ettiswil



PFINGSTEN – WAS WIRD AN PFINGSTEN GEFEIERT?

(Foto: pixabay)

P fingen (auf Albanisch Rrëshajët) wird 50 Tage nach Ostern gefeiert und es geht um das Kommen des Heiligen Geistes und auch als «Geburtstag der Kirche der Gemeinschaft aller Christen».

Der Name Pfingsten leitet sich ab vom griechischen «pentekoste», was übersetzt «fünfzig» heisst. Mit Pfingsten endet die Osterzeit im Kirchenjahr.

Nach der Auferstehung Jesu, fühlen sich die Apostel, Jüngerinnen und Jünger von Jesus verlassen und ängstlich und wissen nicht mehr weiter. Das Versprechen von Jesus erfüllt sich an Pfingsten. Er hat den Aposteln und den Jüngerinnen und den Jüngern in den Begegnungen nach seiner Auferstehung versprochen, dass er immer bei Ihnen sein werde und sie nie verlassen würde. Er dachte dabei an den Heiligen Geist, eine der drei Formen, unter denen Gott den Menschen erscheinen kann.

Gott tritt im Christentum in drei Gestalten auf, nämlich als Vater, Sohn und als Heiliger Geist. Jesus benennt im Alten Testament Gott als seinen Vater, aus diesem Grund nennen ihn auch die Christen «Vater». Im Neuen Testament erscheint Gott den Menschen in der Person Jesus Christus. Nach der Auferstehung Jesu an Ostern ist Gott nicht weg, sondern wirkt als Heiliger Geist unter den Menschen. Als Symbol des

Heiligen Geistes steht die weisse Taube.

In der Bibel in der Apostelgeschichte 2, 1-13 steht, dass an Pfingsten plötzlich ein kräftiger Wind brauste, und die Versammelten sahen Feuerzungen über sich. Der Heilige Geist kam über sie und schuf eine Gemeinschaft. Es wird vom «Pfingstwunder» gesprochen, als die Jüngerinnen und Jünger Jesu vom Heiligen Geist erfüllt wurden und verschiedene Sprachen sprechen und verstehen konnten. Sie sollen die christliche Botschaft verkünden und am Leben halten. Seit diesem Pfingstwunder erzählten sich immer mehr Menschen von Jesus. Denn die Aufgabe der christlichen Kirche ist es, an Jesus zu erinnern.

Dieses Pfingstwunder soll zugleich ein Zeichen dafür sein, dass die christliche Botschaft sich an alle Menschen richtet, unabhängig welche Sprache sie sprechen.

Auch wenn man den Heiligen Geist nicht sehen kann, so kann man ihn durchaus spüren. Der Heilige Geist ist die Kraft der Veränderung, die von Gott ausgeht. Er verändert und erneuert die Menschen innerlich und stellt eine Verbindung zwischen Gott und dem Menschen her.

Die Pfingstgeschichte ist nachzulesen in der Apostelgeschichte 2, 1-13 oder bei Johannes 20,19-23.



FESTA E KORPIT DHE GJAKUT TË KRISHTIT

Foto: Gasperi, Merfuri

Më 8 qershor kemi kremtuar festën e Korpit dhe të Gjakut të Jezu Krishtit. Kjo festë kremtohet të enjten, pikërisht për arsye se në këtë ditë përkujtojmë themelimin e Eukaristisë së shenjtë. Kjo festë filloi të festohet në shekullin e 13-të, kur Shën Juliana, rregulltare dominikane nga Belgjika, ka pasur vizion në të cilin ka parë hënën e plotë të ndriçuar me një njollë të vogël në të. Hëna, në këtë rast, simbolizon Kishën, ndërsa njolla e vogël paraqet mungesën e kësaj feste. Me kërkesën e motrës Juli-ana, ipeshkvi i vendit ka themeluar festën e Eukaristisë.

Papa Urbani i IV në vitin 1264 festën e Eukaristisë dëshironte ta shpallë si festë për gjithë Kishën Katolike, por, para se ta zyrtarizonte këtë Papa Urbani ndërroi jetë.

Në shekullin XIV papa Gjoni XXII festën e Kor-

pit dhe të Gjakut të Krishtit e bëri festë zyrtare për gjithë Kishën Katolike.

Edhe pse Eukaristia – Korpi dhe Gjaku i Krishtit - zanafillën e ka në Darkën e fundit të së Enjtes së Madhe, për shkak se është vigjilia e të Premtës së Madhe, dhe nuk është e mundur të kremtohet me aq solemnitet kjo festë, prandaj kemi festën e veçantë të Korpit dhe të Gjakut të Krishtit, ku kremtohet në mënyrë solemne, me procesion me të Shenjtërueshmin Sakrament dhe lutje të kushtuar pikërisht kësaj feste.

Edhe në Misionin tonë patëm mundësinë të përjetojmë këtë bukuri, duke kremtuar, së bashku me zvicranët, në famullinë e Shën Palit dhe të Shën Pjetrit në Willisau dhe në mbrëmje në kishën e qendrës tonë në Luzern.

Shkruan: m. Vida Ademi, Luzern



(Foto: Anonim)



TE MENDUARIT BARDH E ZI (RRËFENJA E FERMERIT)

(Foto: pixabay)

Sa shpesh na ndodh që situatat e ndryshme por edhe personat që njohim e i ndeshim në jetët tona, ti ndajmë dy kategori, «i mirë» ose «i keq», ndodhi e tmerrshme ose mrekulli, dhe këtë e bëjmë me një lehtësi të paparë. Por fermeri për të cilin na flet rrëfenja në vazhdim, nuk veproi kështu.

«Ishte një fermer që një ditë prej ditësh kali i tij ishte zhdukur, pra i kishte humbur. Dhe për këtë kishte dëgjuar dhe fqinji i tij që i shkon për vizitë dhe i thotë: “Oh, kjo është shumë keq”. Dhe Fermeri i përgjigjet: “Mirë ose keq, vështirë të thuhet”. Ditë më vonë, kali kthehet dhe sjell me vete shtatë kuaj të tjerë të egër. Dhe fqinji vjen serish dhe i thotë: “Oh kjo është shumë mirë”, dhe fermeri ngre duart dhe i thotë: “Mirë ose keq, vështirë të thuhet”.

Në ditët në vazhdim, djali i fermerit del në kalërim me njërin nga kuajt e egër, gjatë kalërimit ai rrëzohet dhe thyen këmbët. Fqinji afrohet sërish dhe i shprehet: “Oh, ky është një fat i tmerrshëm”. Dhe fermeri i përgjigjet: “Mirë ose keq, është vështirë të thuhet”.

Pas një kohe disa oficer shtetërorë, kaluan duke trokitur nëpër dyert e secilës shtëpi, në kërkim të burrave për që t'i bashkohen ushtrisë, ata trokitën edhe tek shtëpia e fermerit,

panë djalin e tij me këmbë të thyera dhe sigurisht, që nuk e morën por vazhduan rrugën. Dhe fqinji afrohet serish dhe i thotë: “Oh, ky është fat i jashtëzakonshëm”. Dhe fermeri tha: “Mirë ose keq, vështirë të thuhet.”

Kjo është një urtësi e jashtëzakonshme që na jep e mëson fermeri, i cili në dallim prej fqinjit nuk e sheh botën e as situatat në ekstreme, vetëm mirë ose keq, e tmerrshme apo e jashtëzakonshme, ai, sikurse vetë realiteti, është fluid dhe kështu nuk mbyllet e as nuk hedh poshtë aftësinë për ta parë situatën prej së vërteti, në mënyrë më komplekse.

Pra, në njërin anë kemi fqinjin që gjykimet e tija janë ekstreme dhe pozicionohet në njërin apo skajin tjetër, që kemi të bëjmë me të menduarit bardh e zi (pa ngjyra), ose ndryshe gjithçka dhe asgjë. Dhe në rastin e dytë fermerin, që është i ngadalshëm në gjykimin e tij dhe i jep kohë vetes për ta përjetuar situatën, duke mos e cilësuar as të mirë e as të keqe ndodhinë, duke mos e fryrë atë, e as pozicionuar në asnjërin skaj. Ai nuk e bën gjënë më të thjeshtë të vendoset mes të mirës dhe së keqes, por i lejon vetes ta përjetojë si eksperiencë dhe perspektivë të re. Pra ai e pranon situatën si të tërë, dhe ka përgjigjen e tij të fuqishme «Mirë ose

keq vështirë të thuhet». Derisa i pari beson që bën “drejtësinë” duke u vendosur mes “mirë” apo “keq”, fermeri është i vetëdijshëm se bën drejtësi duke mos u vendosur në njërin nga këto pole. Pra ai ka guximin, empatinë dhe për ta parë edhe anën tjetër të historisë, duke mos e qar krejt energjinë e tij në njërin skaj.

Te menduarit bardh e zi, përse na krijon probleme?

Të menduarit bardh e zi krijon probleme para se të gjithash sepse mendimet tona i ndikojnë emocionet, kështu të menduarit ekstrem bën të lindin emocione ekstreme. “Kjo ishte dita më e keqe e jetës” “Kurrë nuk mund t'ja dal” “Asgjë nuk shkon për së mbari” “E tmerrshme”. Këto mund të jenë disa pohime ekstreme për situata të përditshme apo të ndryshme, ku fokusi ynë mendor shkon në ekstreme dhe si rrjedhojë do vërshohemi nga emocione negative si zhgënjimi dhe dëshpërimi. Të menduarit bardh e zi kështu kontribuon po ashtu në depresion dhe ankth, sepse personat me depresion priren të mendojnë në ekstreme, dhe ne mund ta luftojmë depresionin apo problemet e tjera mendore duke pasur modele më reale, të moderuara dhe të hapura të të menduarit.

Të menduarit bardh e zi, gjithashtu krijon ndjenjën se ne jemi të pafuqishëm për të ndry-

shuar diçka, dhe për këtë ne as që provojmë, për të arritur diçka. Për shembull, nëse do shpreheshim për tjetrin: “ai është plotësisht i marrë” “më i keqi në botë”, pra nuk ka kuptim të provohet për të ndryshuar diçka apo për të përmirësuar diçka te vetja, sepse “asgjë” nuk funksionon. Pra të menduarit bardh e zi përveç se ndikon në aftësinë për të pasur emocione të shëndetshme, ajo ndikon edhe në aftësinë për të pasur lidhje të shëndetshme, shoqërore ose në çift.

Pra siç e pamë edhe në rrëfenjën e fermerit, të menduarit bardh e zi e bën problemin të jetë më keq sesa realisht është në të vërtetë. Realiteti jetës është më kompleks sesa keq ose mirë, s'ka punë perfekte, s'ka fëmijë perfekt, s'ka martesë perfekte dhe duke i thënë vetes se dikush është perfekt apo i tmerrshëm, ne jemi duke i krijuar vetes takoma më shumë probleme.

“Mire ose keq, vështirë të thuhet”, sa histori njih bota dhe njohim edhe ne që sfidat e jetës i bën më të fortë si persona, duke mos qenë të ngurtë ndaj realitetit dhe jetës, ata nuk u mbështetën tek dy zgjidhje pa ngjyra, por, panë dhe ngjyra mes vështirësive dhe kështu kompletuan historitë e tyre, kështu nuk ranë në dëshpërim por i dhanë kuptim jetës.

*Shkruan: Daniell D. Ukaj,
psikolog klinik, Prishtinë*



(Foto: pixabay)



GRUPI I VALLËZIMIT "SHQIPONJA"

(Foto: Anonim)

Në dhjetor të vitit të kaluar u rithemeluam grupi i vallëzimit "Shqiponjat". Ky grup vallëzimi i përket Misionit Katolik Shqiptar në Luzern.

Me themelimin e këtij grupi, të rinjtë donin të mbanin traditën, vallet dhe gjithashtu identitetin dhe të mësonin shumë më tepër. Është vënë re që Zvicrës qendrore i mungon një grup folklorik shqiptar pasi këtu jeton një numër i madh shqiptarësh.

Grupi, momentalisht, përbëhet nga 43 anëtarë, të cilët kanë zgjedhur kryesinë, të përbërë nga Ardian Lekaj dhe Denisa Merturi, kryetar, ndërsa kryesia përbëhet nga: Raffaella Malota, Agnesa Toplanaj, Robert Laska, Sabina Merturi, Blerta Berisha.

Tashmë është përpiluar edhe statutsi e Ansambllit i cili parasheh detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve. Ky statut është aprovuar nga të gjithë pjesëtarët.



(Foto: Anonim)



(Foto: Anonim)

Fillimi është shumë i mirë, të rinjtë marrin pjesë me shumë vullnet dhe gëzim, ushtrimet zhvillohen mbrëmjeve, njëherë në javë në qendrën e Misionit në Luzern.

Grupi falënderon shumë meshtarin don Antonin, Motrat e nderit si dhe prindërit për mbështetjen e vazhdueshme.

Paraqitja e parë e grupit ishte të dielën me 26 Mars në një ndeshje futbollit në Schönenwerd, ku ishte i ftuar nga *Team Friends United*. Në këtë paraqitje u zgjodhën tri valle të cilat mundësuan një paraqitje dinjitoze në prani të më shumë se 300 mysafirëve të pranishëm në sallë. Kjo përvojë dhe mbështetja e të pranishmëve ngjalli ndjenja

gëzimi dhe njëkohësisht ishte motivuese për të vazhduar në punën dhe qëllimet e grupit.

Po ashtu edhe të hënën e Pashkëve, anëtarët e Ansamblit në bashkëpunim



(Foto: don Anton Uka)

me pjesëtarë të tjerë të Misionit, organizuan dhe realizuan mbrëmjen familjare të Pashkëve. Edhe në këtë festë familjare Ansambli u paraqit me valle të bukura shqiptare të cilat u priten në mënyrë të mrekullueshme nga të pranishmit.

Ansambli ka krijuar edhe simbolet identifikuese. Emblema e Ansamblit përbëhet nga shqiponja e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit dhe nga një çift valltarësh. Çifti i valltarëve është i vendosur në formën e shqiponjës, dhe dëshiron të tregojë se edhe, anëtarët e Ansamblit, dëshirojnë të jenë të lidhur dhe të brumosur nga gjuha, kultura dhe tradita shqiptare që më së miri identifikohen dhe sintetizohen në flamurin tonë kombëtar. Idenë e emblemës dhe realizimin e saj e ka bërë Barbara Merturi dhe Agnesa Toplanaj.

Anëtarët e Ansamblit, kanë vendosur të hapin një llogari në *Instagram* dhe në *Tiktok* @shqiponjaluzern. Kjo është bërë me qëllim që të postohen video dhe fotografi të paraqitjeve dhe ushtrimeve, të bindur se edhe rrjetet sociale janë një mënyrë e mirë për ta promovuar Ansamblin, veçanërisht tek ata që dëshirojnë që ai të jetë i pranishëm në festat e tyre familjare dhe në ngjarjet kulturore. Mbështetja dhe përkrahja e juaj është nxitje dhe motiv për gjithsecilin anëtarë që të vazhdohet të punohet dhe kështu të promovohen vlerat tona kombëtare.

Shkruan: Raffaella Malota dhe Barbara Merturi





(Foto: Skender Hasani)

DËSHMIA E PROFESORIT

Me ftesë të Misionit Katolik Shqiptar në Zvicër dhe të Shoqatës Humanitare “Nënë Tereza”, me datën 17.06.2023, mora pjesë në tubimin kulturor të organizuar prej tyre në Luzern, me titull “Gjurmëve të rrënjëve tona”. Në fokus të këtij tubimi ishte kultura arbëreshe, e cila përbën një nga dukuritë më të veçanta në gjithë historinë e shqiptarëve. Me këtë rast pata nderin që para një audience të madhe bashkatdhetarësh të mbaj ligjëratën me titull “Arbëreshët : model dhe frymëzim në ruajtjen e identitetit kulturor dhe shpirtëror”.

Pjesëmarrja dhe interesimi i madh i pjesëmarrësve për këtë tematikë, janë tregues i qartë se komuniteti shqiptar i Zvicrës, të cilin e mbulon Misioni Katolik Shqiptar aty, përbën një komunitet të konsoliduar kombëtarisht dhe shumë aktiv në çështjet që kanë të bëjnë

me kulturën dhe identitetin shqiptar. Kjo bindje m’u përforcua edhe më shumë kur, pasi mbaroi aktiviteti, pata mundësinë të bashkëbisedoja me shumë prej tyre.

Në historinë e katolicizmit shqiptar parimet *pro fide* dhe *pro patria*, asnjëherë nuk e kanë përjashtuar njëri-tjetrin. Përkundrazi, ato e kanë mbështetur dhe mbrojtur në vazhdimësi njëra-tjetrën. Një shembull personal në këtë drejtim e jep edhe meshtari shqiptar i Luzernit, Don Anton Uka, tek i cili pashë të mishëruar shpirtin e prelatëve të hershëm të katolicizmit shqiptar, atyre prelatëve të cilëve kombi shqiptar do t’u jetë përgjithmonë mirënjohës për punën e madhe të bërë në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave evropiane të këtij kombi, edhe në kohët më të vështira e gati të pashpresa gjatë historisë.

Pata nderin që të dielën e 18-të qershorit

të marr pjesë në meshën e udhëhequr nga Don Antoni në kishën e Shën Gjergjit në Sursee. Aty pashë me sytë e mi shembullin e një meshtari që reflektonte një kulturë të lartë predikimi dhe përkushtim të vendosur atdhetar.

Derisa në qetësinë dhe atmosferën e meshtës së shenjtë po i dëgjoja fjalët e Don Antonit, përpara më doli litania e qindra klerikëve katolikë shqiptarë, që në kohët më të errëta të robërisë osmane kishat i patën kthyer në vatra të shqiptarisë, në shkolla për mësimin e gjuhës shqipe e në qendra të ruajtjes së kujtesës për rrënjët evropiane të popullit tonë.

Më dolën parasysh Pjetër Mazreku, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi, At Shtjefën Gjeçovi, Don Gjon Bisaku, Don Shtjefën Kurti,



(Foto: Gaspër Merturi)

Don Luigj Gashi, e sa e sa të tjerë.

Njerëzit nga mesha gjithmonë dalin me shpirtin e mbushur me shpresën që u jep mesazhi hyjnor i Krishtit, e unë dola i mbushur me shpresën se rruga evropiane e kombit tonë është më e sigurt për derisa kemi njerëz të tillë si Don Anton Uka.

Koha nëpër të cilën po kalojmë është e mbushur me shumë sfida. Shumë prej tyre përmbajnë rreziqe serioze për orientimin tonë kombëtar drejt familjes evropiane, por po ashtu, sot, si kurrë më parë, ne i gëzohemi faktit se i kemi të gjitha mundësitë dhe vetëdijen e nevojshme që të shmangim çdo devijim nga ky orientim, prej të cilit varet krejtësisht ekzistenca jonë si komb në të ardhmen. Dhe sa herë që ta ndjejmë veten të dëshpëruar nga dukuritë e shëmtuara që ngjasin në jetën tonë si komb, duhet të kujtojmë porosinë e dhënë në vargje nga intelektuali i madh i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Luigj Gurakuqi: “Veç një qëllim i naltë t’ban me durue, e zemrën ta forcon; ndër kundërshtime s’vjen kurr me u ligshtue, mjer’ ai që nuk qëndron”.



(Foto: Anonim)

Shkruan: prof. Blerim Latifi, Prishtinë



(Foto: Skender Hasani)

GJURMËVE TË RRËNJËVE TONA

Të nderuar pjesëmarrës dhe dashamirës të Misionit Katolik Shqiptar në Luzern dhe të Shoqatës Humanitare “Nënë Tereza”, më lejon t’ju përsërisht dhe t’ju uroj mirëseardhje në takimin tonë të parë, i cili në fokus ka një çështje shumë të mprehtë, e cila, për fat të keq, kohëve të fundit gjithnjë e më shumë po shtrembërohet, manipulohet dhe po lihet pas dore, e që ka të bëjë pikërisht me rrënjët tona.

Në kohën e pasluftës, në trojet tona të stër-lashta dardano-iliro-shqiptare po vërehen disa dukuri jo të shëndosha, madje edhe tejet të dëmshme për traditën, gjuhën dhe kulturën tonë. Kosova, siç dihet, ka arritur përparime të dukshme në aspektin ekonomik, por, këtë gjë, mjerisht, nuk mund ta pohojmë edhe për fushën politike dhe atë strategjike. Ndikimi i kulturave dhe importimi i traditave dhe ideologjive nga jashtë po ndikon në humbje të identitetit kombëtar dhe ka pësuar një degradim në aspektin kulturor, fetar dhe kombëtar. Përbaltja e figurave më të mëdha kombëtare nga propagandistë të brumosur në kuzhinat turko-sllavo-maqedone, është një alarm i cili po jep një shenjë jashtëzakonisht të rrezikshme për të tashmen dhe sidomos për të ardhmen tonë kombëtare.

Këto dhe shumë fakte të tjera që kohëve të fundit po shpërfaqen në hapësirat e trojeve shqiptare më kanë shqetësuar dhe provokuar tej mase, sa që vendosa për t’u marrë më seriozisht me këtë dukuri. Duke patur parasysh se gjëra të tilla mund t’i rrezikojnë shumë familjet tona edhe këtu në Zvicër, ku falë Zotit dhe vendit ku jetojmë, tani për tani, kemi një diasporë të shëndoshë e shumë të fuqishme, që është e lidhur shumë me kombin.

Shqetësimin tim fillova ta shpalosja pothuajse në të gjitha takimet me njerëz të profileve të ndryshëm dhe pasi e konsumova edhe me anëtarët e kryesisë së Shoqatës humanitare “Nënë Tereza” vendosëm të japim kontributin tonë konkret duke e sensibilizuar opinionin më një takim vjetor si ky i kësaj mbrëmje.

Është për t’u befasuar se përkundër të gjitha shtrembërimeve historike dhe gënjeshtreve të njëpasnjëshme, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, pra akademikët, por edhe politikanët tanë po heshtin, dhe duke vepruar kështu sikur po u shërbejnë agjendave të huaja me programe denigruese për popullin tonë. Por, dëshmia se Zoti nuk i ka çua duart prej nesh është se me ta po konfrontohet një numër i vogël studiuesish trima, që po e ndjekin politikën vizionare të kolosëve të popullit tonë që i dolën në ndihmë gjuhës, traditës dhe kombit në kohërat më të vështira. Në mesin e tyre bën pjesë edhe profesori stoik dhe i paepur Dr. Blerim Latifi dhe gazetari i palodhshëm, z. Rexhep Rifati i cili vite më radhe si bletë punëtores mblodhën nektarin e kulturës shqipe, të cilët na nderojnë sonte me praninë e tyre dhe të cilët kam nderin t’i përsërisht përzemërsisht.

Fjala ‘gjurmë’ në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe do të thotë “rruga ose shembulli që duhet ndjekur”. Takimi me titull “Gjurmëve të rrënjëve tona” mëton të jetë “zëri i atyre që thërrasin në shkretëtirë”, i cili sikur zëri i arbëreshëve tanë, i gjakut të shprishur të Gjergj Kastriotit, nuk mund të shuhet sa të jetë jeta. Në të kundërtën edhe Misionit tonë Shqiptar në Luzern dhe Shoqatës Humanitare “Nënë Tereza” në Luzern, por edhe të gjithë

shqiptarëve të cilët e dinë se në damarët e tyre rrjedh gjaku shqiptar do të duhej tu mbylleshin sytë, sikur tri shtatoreve të figurave kombëtare që gjenden në sheshet e Prishtinës: Gjergj Kastriotit, Ibrahim Rugovës dhe Zahir Pajazitit, që dikush ua mbylli sytë me leckë, kjo si duket për të mos lejuar që të “shohin” se çfarë po ndodh në tokën e bekuar dardane.

I bindur se koha e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare po afron, shpresoj në energjinë pozitive të popullit, kudo që ai jeton, i cili sikurse në ditët më të vështira gjatë historisë edhe kësaj radhe do të gjejë forcë ta mbrojë kulturën, traditën dhe identitetin e lashtë kundër të gjithë atyre spekulatorëve dhe mohuesve të kulturës, gjuhës dhe historisë, të cilët, siç duket, paguhen nga agjencitë antishqiptare dhe antievropiane, të cilët duke dëshiruar të na i fshijnë gjurmët po synojnë të sulmojnë pikërisht trungun e qytetërit tonë të stër-lashtë, që duke sulmuar pjesën më të ndjeshme të kulturës, traditës dhe të vlerave tona shpirtërore, të na sulmojnë rrënjët tona. E ne e dimë se kur rrënja dëmtohet apo helmohet, i tërë trupi do të vuajë pasojat.

Ata që mendojnë ta jetojnë të tashmen e tyre dhe ta ndërtojnë të ardhmen duke i prerë rrënjët, apo duke i mohuar ato, janë të destinuar të mos kenë të ardhme, për vetë faktin se edhe ligji natyror tregon dhe dëshmon se pa rrënjë asgjë nuk jeton.

Ja si shkruan autori i famshëm gjerman, Anselm Grün, në paraqitjen e librit të tij “Rrënjët”: “Kush nuk i njeh rrënjët e veta nuk mund ta dijë për çka ka nevojë pema e jetës së tij që të rritet dhe të zhvillohet përbrenda.” Më vonë, në të njëjtin libër, lexojmë: “Biologjia na tregon se rrënjët, nga njëra anë, e ankorojnë bimën në tokë dhe, nga ana tjetër, e ushqejnë duke thithur ujin dhe kripërat e tretura nga toka. Por, ato nga ana e tyre çlirojnë substanca, duke përfitur kështu edhe tokën. Në të njëjtën kohë, rrënjët nuk janë pa rreziqe. Kërpudhat e dëmshme mund t’i sulmojnë ato, duke i djegur ose kalbur. Edhe parazitët mund t’i dëmtojnë ato. Në përrallën e “Tri flokëve të arta të djallit”, një djalë duhej të zgjidhte një enigmë. Ai duhej të zbulonte përse një pemë që dikur bënte molla të arta, tani nuk jep më as gjethe. Djalli ia zbulon zgjidhjen:

është një mi që ia ha rrënjët; nëse do ta ndaloni miun, pema do të prodhojë përsëri molla të arta. Nëse, nga ana tjetër, askush nuk do ta ndalojë atë, pema do të thahet. Ajo që na mësojnë shkencat natyrore dhe çfarë shprehin imazhet apo simbolikat e përrallave, vlen edhe për jetën tonë. Edhe pema e jetës sonë ka rrënjë, që e ushqejnë dhe që mund të dëmtohen nga parazitët ose nga minj që i dëmtojnë. (...) Nëse nuk u besojmë rrënjëve që kemi marrë nga paraardhësit tanë dhe nga Zoti, (...) pema e jetës sonë nuk do të jetë më në gjendje të prodhojë molla të arta dhe do të thahet”

Ne si shoqëri shqiptare, Akademia e Shkencave, institucionet e kulturës dhe të artit, por edhe fusha politike, duhet të kemi mendime dhe qëndrime të qarta, në mënyrë që dalëngadalë, me kujdes dhe me maturi të pastrohemi dhe të dezinfektohem nga ato kërpudha të dëmshme, nga parazitët dhe nga minj që përbirohen në rrënjët tona të stër-lashta dhe të shenjta, me qëllim që t’i dëmtojnë ato. Ky, sipas këndvështrimit tim, duhet të jetë qëndrimi dhe orientimi ynë i përbashkët, përndryshe vazhdimisht do të jemi të ekspozuar nga viruse të rrezikshme që do ta pengojnë rritjen dhe zhvillimin e jetës tonë shpirtërore, kulturore, politike dhe kombëtare. Po nuk u vetëdijesuem dhe nuk u pas-truam, do të kemi probleme identitare dhe si pasojë integrimi ynë në institucionet e vendeve dhe kombeve të qytetëruar do të jetë shumë i vështirë. Andaj, të bindur se trashëgimia më e madhe që mund t’u lëmë gjeneratave të reja nuk janë vetëm paratë apo gjërat e tjera materiale të grumbulluara gjatë jetës me punë dhe me djersë, por edhe një trashëgimi karakteri dhe besimi. Prandaj ta lusim Zotin, të frymëzohemi nga jeta dhe historia e paraardhësve tanë dhe të punojmë të gjithë së bashku në këtë drejtim, duke dhënë secili kontributin e vet, dhe të mos e harrojmë kurrë kushtrimin dhe testamentin e atyre që jetuan dhe dhanë jetën për gjuhë, traditë, e komb.

(Kjo është kumtesa e plotë e Dr. Don Anton Ukës, udhëheqës i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, në mbrëmjen kulturore “Gjurmëve të rrënjëve tona” të mbajtur në Luzern me 17.06.2023)



Foto: Skender Hasani

ARBËRESHËT – SHEMBULLI I RUAJTJES SË IDENTITETIT

Shumë të nderuar e të respektuar të gjithë ju pjesëmarrës të kësaj ngjarje kulturore, për të kujtuar e hulumtuar lashtësinë, rrënjët dhe fatin e shqiptarëve nëpër botë.

Qëllimi i këtij manifestimi kulturor, që të mbahet pikërisht në mërgatë, këtu në Zvicër, në bashkëpunim mes Misionit Katolik Shqiptar dhe Shoqatës Humanitare “Nënë Tereza” ka një mision tejet fisnik, për identitet nëpër rrënjë të qëndrueshme, e me trup e mendje drejt kulturave kah qytetërimi, sikur e nisën shumë herët ata që e mbollën farën e mirë.

Dëshiroj që në emër të dy institucioneve organizuese, të përshëndesim profesorin e nderuar z. Blerim Latifin; aktivistin dhe autorin e librit “Arbëreshet” z. Rexhep Rifatin; albanologun e nderuar zonjën Ornella Radovicka; si dhe përfaqësuesit nga jeta kulturore dhe politike.

Zonja dhe zotërinj,

Ky takim me karakter kulturor, shfleton kujtesën, traditën, pikërisht nga diaspora e krijuar atëherë, për të mos u pajtuar kurrë me thyerjen e qytetërimeve. Pasuria shpirtërore e racës shqiptare u ndodh mes realitetit e mitit, sepse regjimet na shpërfillen. Për 6-të shekuj u ndodhëm mes krenarisë e qëndresës, sepse nuk u zhbëmë edhe pse deshën të na dehumanizojnë. Në mes kulturave të lindjes e perëndimit, sepse tentuan të na tjetërsojnë por jemi ende gjallë, me gjuhë, me humanizëm, me urtësi e traditë, me shtet e me pasion për jetën.

Tematika e këtij debati, me fokus për Arbëreshët, që nga eksodi i shekullit të 15-të, na fut në një horizont plot ndjenja dhe na sjell deri sot, edhe këtu ku jemi në shtetin helvetik, se si iu përballëm valëve emigruese.



(Foto: Skender Hasani)

Mbijetesa e Arbëreshëve e karakteri i tyre njerëzorë, u bë mësim se si ruhet identiteti shqiptarë dhe pastaj si mbushet shpirti me dashuri e krenari për vendin e vet.

Arbnorët këtë identitet e morën me vete, edhe në Itali, në Argjentinë, në Greqi, në Amerikë, në Misir, e në shumë vende të tjera, duke e ruajtur me elementin e veshjes, shkrimit, artit, e zakoneve të tjera. Thuhet se koha e bren edhe hekurin, përderisa nuk kanë mundur ta ruajnë deri në fund këtë trashëgimi, së paku në gjuhë e deri te shumëllojshmëria kulturore.

Të nderuar të pranishëm, rrjedhat e kohës janë tejet me rëndësi, kur, ku dhe në ç' mënyrë veprohet.

Nga një kompaktësi që po e riaktivizojmë këtu në mërgatë, me subjekte, personalitete të dëshmuara, hulumtues e kontribues, do të provojmë të evokojmë identitet kujtuese, nga e kaluara jonë. Po e nisim me Arbëreshët, e do të jemi së bashku edhe në shumë aktivitete të tjera, pasi që sfondi historik shqiptar ka një pasuri të rrallë që i shërben edhe trashëgimisë kulturore botërore.

Besoj se edhe temat, edhe kumtesat do të shpalosin fakte dhe ngjarje nga e kaluara jonë historike.

Këtu prezent kemi personalitete dhe studiuues të cilët do të prezantojnë disa tema me interes për tu njohur me arbëreshët dhe që janë me interes edhe për gjeneratat e reja që po rriten në mërgatë.

Në këtë bashkëpunim të sapo nisur, do të jemi së bashku edhe në shumë tema të tjera, me dëshirën që të inkuadrohemi të gjithë, edhe fëmijët tanë që po shkollohen e bëhen kuadro të nivelit evropian nga të gjitha strukturat.

Dhe gjithmonë në bashkëpunim me trojet tona, dhe në koherencë me rrjedhat e jetës, por kurrë pa e harruar traditën tonë, as figurat dhe as ngjarjet që kanë ruajtur identitetin tonë dhe kanë formuar shtete shqiptare.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë manifestim kulturor, uroj që gjatë kësaj mbrëmje të kemi një disponim të mirë.

Po ashtu shprehi mirënjohjen time ndaj Misionit Katolik Shqiptar, të udhëhequr nga Don Anton Uka me bashkëpunëtorë, si dhe për të gjithë të tjerët që shprehën vullnetin në këtë organizim.

(Kjo është fjala përshëndetëse e z. Nue Zallit, kryetar i Shoqatës Humanitare "Nënë Tereza" në Luzern, në mbrëmjen kulturore "Gjurmëve të rrënjëve tona" të mbajtur në Luzern me 17.06.2023)



(Foto: Skender Hasani)



(Foto: Skender Hasani)

MBRËMJA KULTURORE "GJURMËVE TË RRËNJËVE TONA"

Përmes një programi të pasur foljor e kulturor dhe me tema tejet të përzgjedhura që prekin të kaluarën tonë historike, e që kanë peshë edhe për aktualitetin, organizatorët në detaje kishin shkoqit një program të pasur, që jo vetëm u duartrokkit nga publiku tejet reprezentativ e që nderoi artistët edhe me ngritje në këmbë. Programi filloi me këndimin e Himnit epokal të At Gjergj Fishtës, nga kori i Misionit në Luzern e më pas kryetari i Shoqatës Humanitare Nënë Tereza, Ndue Zalli shpalli të hapur programin me një përshëndetje për të pranishmit, duke veçuar Profesorin Blerim Latifin nga Prishtina dhe Dr. Ornella Radovicka nga Milano e Italisë.

Me këtë rast "Arbëreshët: model dhe frymëzim në ruajtjen e identitetit, kulturor dhe shpirtëror" ishte tema në të cilën referoi gjerësisht Prof. Blerim Latifi, duke përfshirë periudha ko-

hore që shkaktuan eksodin masiv të popullatës arbëreshe në Itali, veçmas pas kalimit në përjetësi të kryetrimt tonë kombëtar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

Ndërkaq dy folësit e tjerë, poeti Bardhec Berisha dhe studiuesja Dr. Ornella Radovicka nga Qendra për Studime arbëreshe në Frascinoeto të Kalabrisë referuan për librin tim, "Arbëreshët fotosintezë e shpirtit tim".

Një nga temat bosht të kësaj ngjarje që do të mbahet gjatë në mend, me temë "Gjurmëve të rrënjëve tona", foli nikoqiri don Anton Uka, i cili duke marrë shembuj nga e kaluara, përkujtoi peshën e rëndësisë që duhet t'i japin akademitë e shkencave dhe institucionet vlerave të veçanta nga tradita jonë me peshë sa kombëtare aq edhe humanitare. Don Antoni po ashtu falënderoi gjithë pjesëmarrësit dhe ata që i kontribuan në forma të ndryshme këtij ak-

tiviteti edhe atë kryesisht në baza vullnetare.

Gjithsesi kjo mbrëmje do vlerësohet edhe për disa pika kulmore artistike, me një repertor tejet të përzgjedhur me këngë nga pianistja e mirënjohur Ermira Lefort dhe këngëtarja po ashtu shumë impresionuese Enkelejda Basha, të cilat arritën të ngrenë në këmbë edhe publikun e shumë në sallë.

Ambientit një pamje edhe më mbresëlënëse ia dhanë me punimet e tyre piktorët: Marigona Toma, Kristina Martini-Komani dhe Arsim Berisha, duke e kompletuar programin përmes një ekspozite të përbashkët. Do tu hynim në hak po mos ti përmendim edhe të rinjtë e të rejtat të rreshtuar përmes Ansambllit “Shqiponja” si dhe personelit të kuzhinës Kastriot dhe Vera Frrokaj, që me aq shumë shije i kishin përgatitur ushqimet për tërë atë mori publiku.

Sa përket mua, që ndërpreva edhe pushimin në Kosovë për të ardhur në këtë eveniment, u jam falënderues si organizatorëve, po ashtu edhe oratorëve që me një përkujdesje të veçantë folën për librin tim kushtuar vëllezërve arbëresh.

(Marrë nga portali Prointegra, autor i tekstit Rexhep Rifati)



(Foto: Gaspër Merturi)

Shtator 2023

01.09.2023

18:30 E premtja I e mujait, adhurimi dhe Mesha në Luzern

02.09.2023

19:00 Treditëshi i Nënë Terezës, Mesha në Luzern

03.09.2023

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Sursee
18:00 Mesha në Giornico

04.09.2023

19:00 Treditëshi i Nënë Terezës, Mesha në Luzern

05.09.2023

19:00 Festa e Nënë Terezës, pas Meshe Aperò

07.09.2023

19:00 Prova me Korin në Willisau

08.09.2023

19:30 Festa e Lindjes së Zojës, Mesha në Luzern
20:00 Prova me korin në Luzern

09.09.2023

Shtegtimi te Bruder Klaus në Flüeli Ranft

10.09.2023

13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Willisau

14.09.2023

19:00 Prova me korin në Goldau

15.09.2023

19:45 Prova me korin në Luzern

16.09.2023

17:00 Mësim feje në Luzern

17.09.2023

10:30 Mesha në Goldau
13:30 Mesha në Luzern

21.09.2023

19:00 Prova me korin në Luzern

22.09.2023

19:45 Prova me korin në Luzern

23.09.2023

17:00 Mësim feje në Luzern

24.09.2023

10:00 Mesha e përbashkët me zviceranët në Luzern, St. Michael
13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Menznau

28.09.2023

19:00 Prova me korin në Goldau

29.09.2023

19:45 Prova me korin në Luzern

30.09.2023

17:00 Mësim feje në Luzern

**AZB 6005 Luzern
Post CH AG**
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:
Nr. 3/2023
15. September 2023

Erscheint im
Oktober 2023

Impressum
Misioni Katolik Shqiptar në Luzern
Katholische Albanische Mission in Luzern

Verlag und Redaktion
Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës
Rodteggstrasse 6
CH-6005 Luzern
Tel: +41 41 250 52 60
Cel: +41 79 371 68 91
E-Mail: ukas_cr@hotmail.com
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch

Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.



Me etikë të syçeltësisë, Martini kupton të jetuarit plotësisht të jetës, të historisë, të marrëdhënieve, të zgjedhjeve, të qëndrimeve, në horizontin e fatit të tyre të fundit, duke pritur Zotin që vjen. Etika e syçeltësisë do të thotë edhe thirrje për të jetuar me përgjegjësi dhe me entuziazëm çdo akt të pranisë së Hyjit dhe për të kuptuar se vlera më e lartë e çdo zgjedhjeje morale gjendet në përpjekjen për t'i pëlqyer Hyjit dhe për ta shenjtëruar emrin e tij duke bërë vullnetin e tij. Këtë mënyrë të të

jetuarit dhe të të vepruarit, Martini e quan etikë të shoshitjes.

Nga sa u tha del qartë se horizonti i fundit i njeriut, për të cilin u fol më lart, është Hyji, që bëhet pastaj kriteri i çdo vendimi moral; e gjithë kjo, sipas propozimit martinian, e gjen realizimin e vet dhe plotësinë e vet në shpresën e misterit pashkor të vdekjes dhe të ringjalljes së Krishtit, që në profilin moral, bëhet pastaj edhe vdekja dhe ringjallja e shpresës njerëzore.

Të ndihmojmë Misionin tonë!

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3
Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 | 6005 Luzern